Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/308
Datë: 13.05.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** dhe **Validohet** Institucioni "Melita & Partners" me adresë: Objekti Arting, Rr. Tirana, nr. 31, Lakrishe, kati XII nr. 33 në Prishtinë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 29.04.2024 deri 28.04.2027, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve:

   1.1 **Nëpunës i Kontabilitetit, Niveli IV** sipas KKK, Kualifikim Kombëtar Profesional me 26 kredi të Arsimi dhe Aftësimit Profesional (AAP). Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit në tre (3) cikle brenda një viti kalendarik, me nga dy (2) grupe brenda një cikli të trajnimeve me nga 20 kandidatë në grup. Në total institucioni mund të regjistroj njëqind e njëzetë (120) kandidatë brenda vitit.

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni "Melita & Partners" SH.P.K , me adresë: Objekti Arting, Rr. Tirana, nr. 31, Lakrishte, kati XII nr. 33 në Prishtinë, ka parashtruar në AKK kërkesë për akreditim dhe validim të institucionit për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar kualifikimin: Nëpunës i Kontabilitetit niveli i IV sipas KKK. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushë veprimtaria e AKK-së ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për

validimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Pas realizimit të vizitës nga ekipi i ekspertëve në këtë institucion dhe trajtimit në detaje të dokumentacionit, ekipi i ekspertëve në raportin vlerësues përfundimtar të hartuar me datë 13.03.2024 ka dhënë vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje.
Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues, vlerësues dhe certifikues i trajnimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Këshilli Drejtues i AKK-së me datën 29.04.2024 ka mbajtur mbledhjen e tij, ku si pikë e rendit të ditës ka shqyrtuar dhe analizuar raportet vlerësuese të ekipit të ekspertëve. Këshilli Drejtues i AKK-së ka kërkuar nga institucioni Melita & Partners SH.P.K që në afat prej nënëtdhjetë (90) ditësh nga akreditimi të nxjerr rregullore për vlerësimin e kandidatëve me aftësi të kufizuara arsimore, si dhe të rregullohet infrastruktura (toaletet) për këtë kategori sepse institucioni në bazë të dokumentacionit të ofruar nuk ka dëshmuar se e ka të rregulluar çeshtjen e toaleteve për përsonat me aftësi të kufizuar. Këshilli Drejtues i AKK-së pas analizimit të raportit vlerësues të ekipit të ekspertëve për validim kërkon nga institucioni që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të bëjë hulumtim të tregut të punës dhe të ofroj dëshmi me të cilën vërtetohet se është analizuar tregu i punës sa i përket këtij kualifikimi. Këshilli Drejtues me shumicë votash vendosi që me qëllim të vlerësimit nese institucioni i përmbush kërkesat e caktuar si më lartë të bëhet monitorim nga ana AKK-së.

Andaj, në bazë të kërkesës për akreditim dhe validim të Institucionit "Melita & Partners" SH.P.K, rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhënë në Raportin e vlerësimit për akreditim dhe validim për këtë institucion, si dhe bazuar në kërkesat e Këshillit Drejtues si më lartë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij vendimi i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:
1. Institucionit "Melita & Partners" SH.P.K"
2. Arkivit të AKK-së

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së